

AKT THEMELIMI
PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ARLAS”

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë , në ligjin Nr.7512 datë 10.08.1991 “ Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës se lire dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit” , të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R.

Ky akt themelimi u përpilua nga ortaku I vetëm themelues:

Anton Kallaku, i biri i Beharit, lindur në Tiranë më 28.02.2000, banuese në Krujë, me numër personal K00228006U, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

E cila në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “**ARLAS**” si më poshtë vijon:

Neni 1

Themelimi

Ortaku I vetëm themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi Ligji Nr.9901 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Shoqëria doti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega . Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

Neni 2

Emërtimi dhe Selia

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të emërtohet “ARLAS” Shpk. (në vijim e quajtur vetëm shoqëria). Shoqëria do të fitojë personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
2. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Fshati Bubq-Budull, Ndërtesa nr.165, Krujë.
 - a. Shoqëria mund të krijojë filial, zyra apo degë të tjera për të ushtruar veprimtarinë e saj brenda apo jashtë vendit me vendim të ortakëve të shoqërisë.

Neni 3

Objekti

1. Shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj aktivitetet e mëposhtme:
 - a. Tregti me pakicë të artikujve të ndryshëm, eksport-import.

Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, shoqëria mund të kryejë cdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

Shoqëria në veprimtarinë e saj zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 4

Kohëzgjatja

Afati I veprimtarisë së shoqërisë do të jetë për një kohë të pacaktuar (pa afat).

Ortaku me vendim ka të drejtë të bëjë ndryshime në kohëzgjatjen e shoqërisë sitë cmohet e arsyeshme prej tij. Me vendim të asamblesë së ortakëve kjo shoqëri mund të mbyllet.

Prishja dhe likuidimi I shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së ortakëve në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

Dita fillestare do të quhet dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

Neni 5

Kapitali

Kapitali I shoqërisë do të jetë 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë), I përbërë nga 1 (një) kuotë në pronësi të ortakut themelues që përbën 100% të kapitalit themeltar. Kapitali themeltar është tërësisht I nënshkruar dhe shlyer. Kapitali themeltar mund të shtohet ose të pakësohet

Fitimi I realizuar nga aktiviteti I shoqërisë I takon ortakut themelues.

Neni 6

Struktura juridike dhe administrimi I shoqërisë

- a. Organet e shoqërisë janë: Asambleja e ortakëve dhe administratori I shoqërisë.
- b. Ortaku I vetëm ka të drejtë të emërojë dhe administrator të tjerë të vlerave material, të caktojë financiar, likuidator dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.
- c. Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në gjykatën e rrethit gjyqësor.
- d. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme me tekstin rreth saj.

Neni 7

Dispozita të fundit

Ndryshimet në këtë akt mund të bëhen vetëm me shtesë me shkrim.

Pjesë e pandarë e këtij akti është dhe Statuti I shoqërisë I cili nënshkruhet rregullisht nga themeluesi I shoqërisë.

Ky akt themelimi u hartua në Tiranë në 2 kopje origjinale, I cili nënshkruhet rregullisht konform ligjit.

THEMELUES

ANTON KALLAKU

Ortak I vetëm